

APPROACHES TO TEACHING FAIRY TALES

Merita Banjica

Faculty of Languages, Cultures and Communication SEEU, Tetovo, North Macedonia
meritabanjica@yahoo.com

Abstract: Teaching is the personal mastery of each teacher to reflect effective teaching strategies to facilitate students understanding of learning during the teaching process.. The development of each lesson requires planning, organizing and implementing different learning activities.

Many different teaching methods and forms are applied during this process, but when applied with a combination of verbal, auditory, and visual techniques they are more perceived and are remembered more. Following is the development of a teaching unit, where the main purpose is to acquaint students with folk-fairy tales.

The purpose of this paper is to clarify the strategy of teaching the Albanian language subject in the field of popular literature, which focuses on the objectives:

- clarifying the teaching process
- clarifying the concept of fairy tale as an advisory creation for people to enrich themselves with civic values such as the value of virtue and the value of work activity.

Keywords: folkcreativity, fairy tale, teaching strategies.

QASJA NË MËSIMDHËNIEN E INTERPRETIMIT TË PËRRALLËS

Merita Banjica

Faculty of Languages, Cultures and Communication SEEU, Tetovo, North Macedonia
meritabanjica@yahoo.com

Abstrakt: Mësimdhënia është mjeshtëri vetjake e çdo mësimdhënësi për të reflektuar strategji mësimore efikase për ta lehtësuar kuptimin e mësimin nga nxënësit gjatë procesit të mësimdhënies. Zvillimi i çdo njësie mësimore kërkon planifikim, organizim dhe zbatim të aktiviteteve të ndryshme mësimore.

Gjatë këtij procesi zbatohen shumë metoda dhe forma të ndryshme mësimore, mirëpo ato kur zbatohen me kombinimin e teknikave verbale, auditive dhe vizuale përceptohen më mirë dhe mbahen mend më gjatë. Në vijim ofrohet zhvillimi i një njësie mësimore, ku qëllimi kryesor është njohja e nxënësve me krijimtarin popullore-përralla. Qëllimi i këtij punimi përqendrohet në sqarimin e strategjisë së mësimdhënies të lëndës së gjuhës shqipe nga fusha e letërsisë popullore, që përqendrohet në objektivat:

- sqarimi i procesit të mësimdhënies
- sqarimi konceptit përrallë si krijim këshillëdhënës për njerëzit për ta pasuruar veten me vlerat qytetare si vlera e virtytshmërisë dhe vlera e aktivitetit të punës.

Fjalë kyçe: krijimtari popullore, përrallë, strategji mësimore.

1. HYRJE

Ideja për t'iu qasur këtij studimi për vlerën e krijimtarisë popullore përrallën, u reflektua nga përvoja ime si mësimdhënëse në shkollë fillore, ku gjatë procesit të mësimdhënies të njësisë mësimore u përdorën strategji të ndryshme mësimore për ta lehtësuar interpretimin dhe kuptimin e tekstit nga nxënësit.

Në vijim ofrohet sqarimi i procesit të mësimdhënies, i cili kalon në gjashtë faza mësimore. Në çdo fazë ofrohen aktivitete të ndryshme për t'i angazhuar nxënësit në punë. Gjatë këtij procesi ofrohen edhe sqarime teorike për përrallën si krijim popullor. Mjeshtria e një mësimdhënësi profesional reflektohet me arritjen e profesionalizmit, që nga përvoja mësimore të krijojë teori shkencore didaktike.

2. PROCESI I MËSIMDHËNIEN SË NJËSISË MËSIMORE " PËRRALLË " ME MESAZH EDUKATIV-MORAL

2.1. Sqarimi i konceptit krijimtari popullore

Krijimtaria popullore i përmbledh të gjithë krijimet e gjinisë epike, epiko-lirike dhe lirike të krijuara nga mendja e njeriut. Krijimtaria popullore ndryshe quhet edhe folklor letrar ose letërsi popullore, që si mjet komunikimi kryesor e ka fjalën. Kjo krijimtari është përcjellur gojariht prej brezi në brez si gjini lirike në këngë familjare dhe shoqërore, dhe epike të zhvilluar në formë të poezive si këngë kreshnikësh dhe këngë legjendare, por bëhet edhe një klasifikim

si gjini epiko-lirike me balada popullore, si gjini epike në formë të rrëfyerit gojor, si përrëllaza, përralla, legjenda, anegdota, fjalë të urta dhe gjëgjëza(gjëgjëzat mund të jenë edhe në vargje). Kjo krijimtari tani mund të gjendet edhe me shkrim në përmblendhje të ndryshme të mbledhura nga shkrimtarë të ndryshëm.

Të gjithë krijimet duke u përcjellur prej brezi në brez dhe prej një mjedisi në një mjedis tjetër, vazhdimisht kanë pësuar ndonjë ndryshim me plotësime ose heqje, ashtu që janë rigjenuar si vlera kulturore të komunitetit përmes bisedave dhe praktikave brenda familjeve, brenda komunitetit. Të gjithë këto vlera janë transmetuar me performancat e tyre dhe duke u studiuar kanë arritur të vlerësohen nga komuniteti, të cilit i takojnë, por edhe te të tjerët, të cilët i kanë pranuar.

Folklori, si dukuri artistike e lidhur me jetën e njeriut primitiv, mund të themi se është i vjetër sa vetë njeriu. Populli shqiptar ndër shekuj ka krijuar një kulturë shpirtërore të pasur, cila sipas studimeve të shumë folkloristëve shqiptar dhe botëror mund të krahasohet me atë të popujve të vjetër të Evropës. (Kërluku,D 2017).

Në periudhën e hershme historike të krijimtarisë popullore janë rrëfyer ngjarje nga periudha e egërsirës, kur njeriu ka pasur nevojë t'ia komunikoj tjetrit përvojën e tij të fituesit të luftës me kafshët tij, që në fillim e ka paraqitur me gjeste e më vonë me gojarishtë me fjalë. Krijimtaria popullore pasqyron ngjarje të ngjajshme me jetën shpirtërore të një populli duke e vështiruar nga aspekte shoqërore, ekonomike, familjare, mitologjike, kanunore, ndërnjerëzore morale.(shih: https://sq.wikipedia.org/wiki/Let%C3%ABrsia_gojor parë më 29.01.2020).

2.2. Sqarimi i konceptit përrallë

Përralla është krijim popullor, që përcjell mesazh edukativo - moral. Përralla është krijim epik popullor, ku rrefehet një ngjarje me qëllim nxitës për t'i vetëdijësuar njerëzit për ta vlerësuar vlerën e angazhimit vetjak në punë dhe vlerën e krijimit të vetive të virtytshmërisë. Të dy këto vlera janë shumë të vlefshme për zhvillimin e njeriut në drejtim të zhvillimit individual për reflektim të vlerave qytetare, të jetë punëtor me reflektimin e përgjegjshmërisë ndaj çdo pune dhe të jetë i virtytshëm me reflektimin e sjelljes së mirë, që zhvillojnë individin dhe shoqërinë.

Përrallat zakonisht fillojnë ose brenda rreshtit të parë i kanë fjalët "na ishte njëherë", "rronte njëherë", etj. Përrallat kanë marrë një vlerë të veçantë të të gjithë, përshkak se janë rrëfyer nga shumica e popujve, prandaj edhe kanë marrë vlerë interkulturore. Në shekullin XXI me ndihmën e internetit dhe përkthimit të tyre në gjuhën angleze përrallat morën edhe vlerë globale, përshkak se nxisin mirësinë, dashurinë, humanizmin, tolerancën në mes njerëzve dhe vlerën e përgjegjshmërisë ndaj punës.

Përrallat janë pjesë të letërsisë popullore, që ndryshe njihet edhe si folklor. Një përrallë është një histori tradicionale, që më parë është transmetuar gojarisht, kurse tani mund ta gjejmë edhe të shkruar. Studime shkencore nga aspekte të ndryshme si kulturore-historike, filologjike-letare, sociologjike dhe aspekte psikologjike janë bërë për përrallën duek e pasqyruar interesin e gjërë mmultidisiplinar për to. Përrallat janë të rëndësishme për nxënësit se lehtësojnë të mësuarit e disa gjuhëve, të kuptimit të rëndësisë së formës gjuhësore për të arritur komunikim specifik, që ndikon në rritjen e ndërgjegjësimit ndërkulturor të tyre. (Lwin, Soe Marlar, 2015).

Forcat e shpejta të globalizmit dhe ndryshimi i realitetit sociolinguistik, anglishten kanë çuar në një zhvendosje paradigme nga mësimi i gjuhës angleze si gjuhë e dytë / e huaj (TESL / TEFL) në mësimin e gjuhës angleze si gjuhë ndërkombëtare ose e parë (TEIL). I informuar nga paradigma e fundit, mësimi i gjuhës angleze duhet të synojë rritjen e ndërgjegjësimit të mësuesve të gjuhës të shekullit XXI, për diversitetin gjuhësor dhe kulturor dhe t'i pajisin ata me aftësinë për të komunikuar kulturat e tyre në anglisht. Ky qëllim për t'ua arritur, studiuesit kryesorë të TEIL argumentojnë se materialet e mësimi të gjuhës angleze (ELT) duhet të përfshijnë përfaqësimin e varieteteve, përdoruesve dhe kulturave të ndryshme në gjuhën angleze. (Lwin, Soe Marlar, 2017).

Përrallat mund të vlerësohen si një shembull i materialeve për të mësuar EIL dhe të sigurojë një kornizë udhëzuese për mësuesit, që të përdorin përralla si një mënyrë për t'i angazhuar studentët në mësim për të zhvilluar kompetencën komunikuese ndërkulturore. (Lwin, Soe Marlar, 2017).

Përrallat në zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve më të vegjël për ta zhvilluar imagjinatën e tyre konsiderohen si burim shumë i mirë edukues, si mjet funksionimi, me të cilën orientohet fëmija mbi mënyrën e funksionimit të marrëdhënie njerëzore. Fëmija e gjen veten emocionlaisht në përrallë, ku tensionet dhe konfliktet e brendshme psikologjike, që i përjeton fëmija marrin zë në përralla. Fëmija e vlerëson përrallën si një nga rrugët kryesore të zgjidhjes së vështirësive, që ka gjatë procesit të gjatë dhe të komplikuar gjatë zhvillimit të tij. (LorelaGaruli, 2019).

Nismëtarët e mbledhjes së folklorit në Evropë janë vëllezërit Grim, Jakobi i lindur më 1786 dhe Wilhelm i lindur më 1789 në Hanau , pranë Frankfurtit, në Gjermani. Përrallat nga folklori nga vëllezërit Grim janë: Kësulkuqja, Borëbardha, Hansel dhe Gretel, Hirushja, Bukuroshja e fjetur etj. Roli i përrallave për nxënësit është shumë i dobishëm se i mëson të bëhen punëtor dhe i mëson të bëhen njerëz të mirë me virtytete. Përrallat nxënëse më të rritur u ofrojnë këshilla të ndryshme edukuese-morale.

2.3. Sqarimi i konceptit strategji mësimore

Strategjia mësimore reflektohet gjatë procesit të mësimdhënies me përdorimin e procedurave, metodave, teknikave dhe formave të ndryshme mësimore për ta lehtësuar për nxënësit kuptimin e mësimi. Organizuesi grafik është paraqitje vizuale (pamore), që tregon marrëdhëniet midis koncepteve, ideve, linjave apo elementeve të një tregimi. Ai është paraqitje mendore, që e bën të menduarit të dukshëm. Organizues të tillë janë kllaster, tabela e koncepteve, tabela e tipareve semantike, digramet e Venit etj. Përdorimi i organizuesve grafik në mësimdhënie më së tepërmi u ndihmon nxënësve, që kanë vështirësi në të lexuar, u ndihmon nxënësve ta përvetësojnë materialin e shkruar duke e përceptuar atë vizualisht në struktura të organizura dhe një format më të qartë me nivelizime të klasifikimeve të ndryshme sipas kategorive të ndryshme. Gjithashtu organizuesit grafik u ndihmojnë edhe nxënësve të përparuar, që kanë vështirësi në analizën e teksteve të gjata. Ndërtimi i organizuesve grafik kërkon angazhimin shprehitë e të mendurit të nivelit më të lartë, ku nxënësit mendojnë në mënyrë logjike, kritike, krijuese dhe analitike. (Musai, B 2014:49).

Përceptim është procesi i kapjes së një ngacmimi dhe formulimi i tij me domethënie kuptimore. Shqisat e të përceptuarit janë të dëgjuarit, të pamurit, të nuhaturit, të prekjes dhe të shijuarit. Të gjithë këto shqisa na ndihmojnë t'i kuptojmë konceptet më qartë dhe më saktë. Organizuesit grafik konsiderohen objekte të përceptimit vizual, që e bëjnë informacionin e përceptuar me kohëzgjatje më gjatë në memorien e individit. Informacioni i përceptuar në mënyrë vizuale nëse shoqërohet edhe me përceptim auditiv të përfutur nga një komunikim verbal atëherë bëhet edhe më afatgjatë në kujtesën e individit (të nxënësit). Strategjitë mësimore nxënësit duhet t'i mësojnë, që t'i praktikojnë në të ardhmen për zgjidhje të problemeve të ndryshme.

Strategji mësimore është metoda, që përdori për të transmetuar informacione tek nxënësit tuaj. Një strategji e përdorur me nxënësit të këtij viti, mund të mos funksionojë me nxënësit e vitit tjetër. Kjo tregon se strategjia e njejtë nuk mund të funksionojë me të gjithë nxënësit se ata janë të ndryshëm, prandaj duhet të zbatoni strategji të ndryshme. Goodwin (2018) dalloi disa strategji më efikase dhe efektive për nxënësit janë:

1. Modelimi nënkupton orientimi i nxënësve në aktivitet pas sqarimit tuaj se si duhet ta bëjnë detyrën. Kjo enxit përceptimin vizual të tyre, për ta kuptuar më mirë se si duhet të punojnë dhe çka të punojnë.
2. Gabimet e juaja të qëllimshme në shënimin e fjalëve në dërrasë për t'u korrigjuar nga nxënësit, për t'i vërejtur reagimet e tyre dhe për të vërejtur aftësitë e tyre.
3. Reagim me informacion kthyes me shkrim ose me gojë " të lumtë", "mirë, por mundesh edhe më mirë".
4. Të mësuarit kooperues mundëson efektivitet në të mësuarit se mësojnë nga njëri-tjetri. Gjatë këtij procesi mësojnë aftësitë e të menduarit kritik, të komunikimit, për zgjidhjen e problemeve etj.
5. Të mësuarit eksperimentues ndodh kur nxënësit punojnë krijojnë përvojë duke e parë konceptin në veprim, të cilin pastaj dikutojnë për përvojën e krijuar, mund të realizohet me simulim, lojë argëtuese, eksperimente etj.
6. Klasa e udhëhequr nga nxënësit zabohet, kur nxënësit marrin përgjegjësi për ta realizuar njësinë mësimore.
7. Diskutimi në klasë i nxënësve të mësojnë nga njëri-tjetri, kurse ju mund t'i vlerësoni njohuritë e tyre.
8. Udhëzimi i drejtuar nga hetimet duke bërë pyetje dhe duke punuar së bashku për të zgjidhur problemet, nxënësit përfshihen në procesin e të mësuarit për ta përcaktuar përgjigjen dhe raportuar atë. Nxënësit kur punojnë vet më mirë i mbajnë mend konceptet.
9. Transparenca objektive e mësimi është kur ju u tregoni nxënësve se çfarë duhet të bëjnë gjatë orës mësimore.
10. Organizuesit grafik përmbledhin informacion në mënyrë të qartë. Kjo u ndihmon atyre ta organizojnë informacionin në mendjen e tyre, në mënyrë që ata t'i kuptojnë më mirë konceptet e reja.

Në vijim pasqyrohet planifikimi i një njësie mësimore me strategji të kombinuara.

2.4. Planifikimi i procesit të mësimdhënies

Tema: Letërsi-Krijimtaria popullore.

Klasa: VIII.

Njësia mësimore: Përralla " I lumtur është ai, që s'kazi".

Qëllimi: Nxënësit njohuritë e marra për përrallat të aftësohen t'i lidhin me njohuritë e qëndrueshme paraprake, që të mund t'i dallojnë përrallat si krijime popullore epike dhe të aftësohen t'i zbulojnë, t'i njohin dhe t'i kuptojnë porositë morale-edukative të përrallës.

Objektivat: Angazhimi i të gjithë nxënësve në procesin e të mësuarit të mësimi me reflektimin e përqendimit kognitiv, afektiv, social dhe psikomotor për kryerjen e aktiviteteve të ndryshme mësimore edhe atë:

- të marrin njohuri për përrallat dhe të aftësohen t'i dallojnë përrallat si krijime popullore.
- të marrin njohuri për gjëritë letrare të krijimtarisë popullore.
- të aftësohen t'i përdorin strategjitë për kuptimin e teksteve në detaje.
- të aftësohen të bëjnë lexim letrar.
- të aftësohen të shprehin interesim për ta pasuruar fjalorin e tyre me fjalë të reja.

- të aftësohen t'i nxjerrin mesazhet e teksteve.
- të reflektojnë qëndrim pozitiv e për leximin e përrallave si tekste me mesazhe për zhvillimin individual për zhvillimin e shkathtësive të punës dhe zhvillimin e vetive të vërtetshme.
- të aftësohen të krijojnë definicionin për përrallat.

Strategjia mësimore: metodat, teknikat, format mësimore

PNP: Paranjohuritë:

- Kriteret e vlerësimit.
- Bashkëbisedim me informatë hyrëse të mësimdhënësit dhe informatë kthyesë gojore të nxënësit.
- Organizues grafik-hartë semantike për sqarimin e konceptit krijimtari popullor.
- Organizues grafik-hartë semantike për sqarimin e konceptit përrallë.

Ndërtimi:

- Organizues grafik për përdorimin e pyetjeve divergjente dhe konvergjentë për kuptimin e tekstit.
- Leximi i drejtuar.
- Pyetje autorit-përgjigje e nxënësit, shënohen në fletore.

Përforcimi:

- Diskutim.
- Formulim i definicionit.
- Detyra shtëpie.

Format e punës: punë në dyshe dhe punë individuale e pavarur.

Vlerësimi: Diskutimi reflekton qëndrimin e nxënësit për porosinë, që e përcjell përralla.

Mësimi i integruar: Njësia mësimore "Përralla" në gjuhën shqipe mund të integrohet me lëndët: gjuhë maqedonase, angleze, gjermane dhe histori.

2.5. Zhvillimi i procesit të mësimdhënies

1. Paranjohuritë

Hapi i parë: *Mësimdhënia*-Në fillim të orës për të fituar koncentrimin e nxënësve në procesin e mësimin shonohet titulli në dërrasë "I lumtur është ai, që s'ka zili"-përrallë popullor, shënohet strategjia PNP, me të cilën do të punohet dhe përcaktohen kriteret e vlerësimit:

- Pjesëmarrja e nxënësve në bashkëbisedim.
- Leximi i përrallës me punë në dyshe (tandem).
- Parashtrimi i pyetjeve dhe dhënia e përgjigjeve në fletore nga të gjithë nxënësit.
- Portretizimi i personazhit.
- Formuloni i definicionit për përrallat.

Hapi i dytë: Mësimdhënësi me bashkëbisedim me nxënësit e bën sqarimin e konceptit krijimtari popullor dhe sqaron klasifikimet e gjinive dhe llojet e tyre.




Figura 1. Organizues grafik -hartë semantike hierarkike për klasifikimin e gjinive letrare popullore.

Hapi i tretë: Bashkëbisedim dhe sqarim të konceptit përrallës.



Figura 2. Organizues grafik-hartë semantike e konceptit

3. NDËRTIMI

Hapi i katërt: Mësimnxënia-Lexim i përrallës nga nxënësit me metodën-Pyetje autorit-përgjigje e nxënësit (strategjia e të pyeturit me pyetje divergjente dhe konvergjente), në të cilën bëhet edhe portretizimi i personazheve. Gjatë kësaj faze të procesit të mësimdhënies mësimdhënësi i orienton nxënësit të lexojnë tekstin dhe të parashtrojnë pyetje për ta kuptuar më mirë atë dhe për t'i zbuluar fshehtësitë e tekstit në detaje. Gjithashtu sqarohen fjalët e panjohura nëse i ka në tekst. Këto pyetje bëjnë qartësimin e ndodhisë (shkakun) së ngjarjes, kohën, vendin, mënyrën, qëllimin e veprimit dhe vepruesin ose personazhin.




Figura 3. Përdorimi i pyetjeve divergjente dhe konvergjente për kuptimin e tekstit në detaje

Tabela 1. Teknika: Pyetje autorit dhe përgjigje nxënësit, me pyetje divergjente dhe konvergjente

Pyetje autorit	Përgjigje e nxënësit
Çfarë ndodh dhe kujt i ndodh ?	Personazh kryesor është mullixhiu, që është shumë i lumtur.
Kur ka ndodhur ngjarja ?	Ngjarja ka ndodhur shumë vite më parë.
Ku ka ndodhur ngjarja?	Ngjarja ka ndodhur në një fshat.
Çfarë kishte ndërtuar mullixhiu?	Mullixhiu kishte ndërtuar një mulli në fshat.
Si ishte ndjerë ai ?	Ai kishte punuar duke kënduar dhe kishte qenë shumë i lumtur.
Përse kishte qenë shumë i lumtur?	Ai çdo punë e kishte bërë shumë me vullnet dhe kishte punuar pandërprerë, përshkak se nuk kishte pasur kohë t'i përfolë të tjerët dhe nuk i kishte pasur zili.
Kush kishte dëgjuar mullixhiun e lumtur?	Mbreti kishte kuptuar për lumturinë e mullixhiut.
Ku kishte shkuar mbreti?	Mbreti kishte shkuar te mullixhiu për ta pyetur nga i kishte ardhur lumturia.
Si ishte përgjigjur mullixhiu?	Mullixhiu i kishte thënë mbretit se lumturia i kishte ardhur nga puna dhe se kurrë nuk e kishte pasur asnjërin zili.
Çfarë kishte bërë mbreti pasi i kishte kuptuar fjalët e mullixhiut?	Mullixhiu ishte kthyer në pallatin e tij dhe kishte filluar të jetojë i lumtur me oborrtarët e tij duke krijuar harmonizim në mesin e të gjithëve me prezencën e tij në mesin e tyre.
Çfarë kuptuat nga përralla?	Të bëhemi punëtorë dhe të virtytshëm.

4. PËRFORCIMI

Hapi i pestë: Diskutim për të zbuluar qëndrimin e nxënësve për vlerësimin e tekstit (përrallës). Qëndrimi i nxënësve për përrallën pritet të reflektohet si qëndrim pozitiv ndaj punës, me të cilën njeriu arrin të bëhet i lumtur, kurse virtytshmëria e individit krijon raporte miqësore dhe harmonizim me të tjerët.

Hapi i gjashtë: Në bazë të sqarimeve të bëra gjatë procesit mësimdhënies nxënësit arrijnë ta kuptojnë mësimin dhe të formulojnë definicionin e përrallës, të cilën e shënojnë në fletore. Nxënësve u përcaktohen detyra për formulimin e fjalive sipas tërësive logjike, të cilat do të lexohen orën e dytë dhe do të komentohen. Gjithashtu mund t'i formulojnë edhe fjalitë për temën dhe idejën (mesazhin e përrallës).

5. PËRFUNDIM

Në bazë të gjithë të dhënave teorike për mësimdhënien u zbatua një njësi mësimore në klasë vetëm me ndihmën e librit, fletore dhe shkumës. Mirëpo sikur në çdo klasë të kishte nga një kompjuter, projektor dhe mjete të tjera mësimore ndoshta mësimdhënia akoma do të lehtësohej për të dy palët, që veprojnë në klasë. Organizuesit grafik janë teknika, që e lehtësojnë kuptueshmërinë e mësimin me të përcëptuarit vizual dhe ndihmojnë

në lidhshmërinë kognitive të njohjeve, të cilat në të ardhmen mund të përdoren nga nxënësit për të krijuar dije të reja. Strategjitë mësimore ose kombinimi i metodave, teknikave dhe formave të ndryshme mësimore të përdora në klasë janë lehtësues për të mësuarit e nxënësit në çdo lëndë, në çdo vend dhe në çdo kohë. Çdo përvojë mësimore mund të shndërrohet edhe në teori mësimore. Përrallat kanë qenë, janë dhe do të jenë këshillues për të rinjtë për ta zhvilluar personalitetin e tyre me shkathtësi pune dhe me veti të vërtetshme për të përparuar veten dhe shoqërinë demokratike.

REFERENCAT

- Burns A., & Richards J.C. (2012). Pedagogy and practise in second language teaching, Cambridge University Press, New York, NY 10013-2473, USA.
- Garuli, L. (2019). Roli i përrallave në edukimin dhe zhvillimin e fëmijëve parëmë 28.10.2020 <https://www.familjadhe.shendet.com/roli-i-perrallave-ne-edukimin-dhe-zhvillimin-e-femijeve/>
- Goodwin, J., (2018). Top 10 Teaching Strategies to Use in Your Classroom parë më 29.01.2020 BY JAMIE GOODWIN ON APRIL 11, 2018 IN TEACHERS, STUDENT TEACHING, HIGH SCHOOL, CLASSROOM, MIDDLE SCHOOL, ELEMENTARY, COLLEGE <https://go.magoosh.com/schools-blog/top-10-teaching-strategies>
- Lwin, S.M. (2015). Using Folktales for Language Teaching -The English Teacher; Seri parë më Kembangan Vol. 44, Iss. 2, (Aug 2015): 74-X. <https://search.proquest.com/openview/641ffb4f61133f5bf9dc3b1fa0649dfd/1?pq-origsite=gscholar&cbl=13063575>
- Lwin, S. M. (2017). Using folktales as a way to operationalise the paradigm of teaching English as an international language <https://www.tandfonline.com/doi/abs/10.1080/13488678.2018.1440279>
- Matthewes, B., & Ross L. (2010). Metodatat e Hulumtimit-Udhëzues praktik për shkencat sociale dhe humane, CDE (QAD) -Tiranë.
- Musai, B. (2014). Metodologji e mësimdhënies, Arti dhe shkenca për të përgatitur nxënësit të suksesshëm, CDE, botimi i dytë, CDE (QAD)-Tiranë f. 3.
- Osmani, Z., & Bojku, F. (2009). Gjuha Shqipe dhe Leximi për klasën e VIII, me vendim të Republikës së Maqedonisë nr.10-1618/1 të datës 19.06.2009, ky libër shkollor lejohet për përdorim. Përralla: "I lumtur është ai që s'ka zili" f. 43.
- Temple, C., et all. (2006). Strategji të mësimdhënies, CDE (QAD) -Tiranë.
- Woolfolk, A. (2011). Psikologji edukimi, CDE (QAD)-Tiranë.
- Concepts i folk parë më 29.01.2020 https://en.wikipedia.org/wiki/Concepts_in_folk_art
- Teaching Strategies parë më 29.01.2020 në <https://cehs.unl.edu/secd/teaching-strategies/>
- Teaching Strategies: 5 Ideas for Instructing Vocabulary parë më 29.01.2020 në <https://www.teachhub.com/teaching-strategies-5-ideas-instructing-vocabulary>
- Instructional Strategies parë më 29.01.2020 në <https://www.encyclopedia.com/education/encyclopedias-almanacs-transcripts-and-maps/instructional-strategies>
- Letërsi gojore parë më 29.01.2020 https://sq.wikipedia.org/wiki/Let%C3%ABrsia_gojore